




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera- Office of the Prime Minister

AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË
AGENCIJA ZA HRANU I VETERINARSTVO
FOOD AND VETERINARY AGENCY



 Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë Manuali	PSO Procedurat Standarde të Operimit për kryerjen e inspektimeve (monitorimit) dhe mostrimit për identifikimin e djegies bakteriale <i>Erwinia amylovora</i> dhe zbatimin e masave fitosanitare	Dok.-Nr.: 07-109-001 Versioni: 1.0. Faqe: 7 Statusi: 30.01.2019.
--	--	---

Titulli:	Procedurat Standarde të Operimit për kryerjen e inspektimeve (monitorimit) dhe mostrimit për identifikimin e djegies bakteriale <i>Erwinia amylovora</i> dhe zbatimin e masave fitosanitare
Fushëveprimi:	Administrata Fitosanitare
Fjalët kyçe:	Inspektimi (monitorimi), mbikëqyrja, djegia bakteriale, bimët nikoqire, mostrimi, përgatitja e mostrave, dërgimi për testim, raporti i inspektimit, rezultatet e testimit laboratorik, zbatimi i masave fitosanitare, vendimi, shpërthimi
Legjislacioni dhe dokumentet relevante	LIGJI NR. 04/L-120 PËR MBROJTJEN E BIMËVE Udhëzimi Administrativ nr. 12/2014 për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes djegia bakteriale - <i>Erwinia amylovora</i>
Referencat e tërthorta:	Monitorimi për identifikimin e pranisë së (djegies bakteriale) <i>Erwinia amylovora</i> Inspektimet në vende të ndryshme të bimëve nikoqire të djegies bakteriale Mostrimi dhe përgatitja e mostrave për testim laboratorik Veprimet në rast të identifikimit të djegies bakteriale Mbikëqyrja e shpërthimeve

Hartuar nga:	Naim Delijaj – Inspektor fitosanitar Ismet Fejzullahu – Shef i Sektorit të Inspektoratit Fitosanitar - AUV Burim Ahmeti - Inspektor fitosanitar Islam Mulaj - Inspektor fitosanitar kufitar Agita Pence – ekspert i shtetit anëtar të BE Gunita Škuppele – ekspert i shtetit anëtar të BE	Data: 30.01.2019.
---------------------	--	--------------------------

 Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë Manuali	SOP Procedurat Standarde të Operimit për kryerjen e inspektimeve (monitorimit) dhe mostrimit për identifikimin e djegies bakteriale Erwinia amylovora dhe zbatimin e masave fitosanitare	Dok.-Nr.:07-109-001 Versioni: 1.0. Faqe: 7 Statusi: 30.01.2019.

Bashkënëshkruar nga:	Ilirjana Zymberaj – Drejtoresh e Inspektoratit të AUV	Data: 18/03/2019
Miratuar nga:	Kujtim Uka – Menaxher i Cilësisë	Data: 18/03/2019
Përfundimisht nënshkruar nga:	Valdet Gjinovci – Kryeshef Ekzekutiv I AUV	Data: 19.03.2019
Në fuqi që nga:		Data:

Arsyeja për përditësimin e fundit:		Data:
Përditësimi i fundit:		Data:
Përditësimi i bashkënëshkruar nga:		Data:
Miratuar nga:		Data:
Përditësimi përfundimisht i nënshkruar nga:		Data:

Përmbajtja

I Çështjet e përgjithshme	3
II Inspektimi (Monitorimi)	4
III Inspektimi i materialit shumëzues të bimëve nikoqire në fidanishte	4
IV Inspektimi i burimeve gjenetike	5
V Marrja e mostrave në rast të simptomave vizuale të djegies bakteriale	5
VI Veprimi në rast të identifikimit të djegies bakteriale	6
VII Monitorimi në vendin e shpërthimit	7
Aneksi	7

 <p>Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë</p> <p>Manuali</p>	<p>SOP</p> <p>Procedurat Standarde të Operimit për kryerjen e inspektimeve (monitorimit) dhe mostrimit për identifikimin e djegies bakteriale <i>Erwinia amylovora</i> dhe zbatimin e masave fitosanitare</p>	<p>Dok.-Nr.:07-109-001</p> <p>Versioni: 1.0.</p> <p>Faqe: 7</p> <p>Statusi: 30.01.2019.</p>
--	---	---

Procedurat Standarde të Operimit për kryerjen e inspektimeve (monitorimit) dhe mostrimit për identifikimin e djegies bakteriale *Erwinia amylovora* dhe zbatimin e masave fitosanitare

I Çështjet e përgjithshme

1. Kjo procedurë e operimit përcakton procedurën se si inspektorët fitosanitar (në tekstin e mëtejshme inspektorë) e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (në tekstin e mëtejshme AUV) kryejnë inspektime (monitorim) dhe mostrimin për identifikimin e djegies bakteriale *Erwinia amylovora* (Burr.) Winsl. etj. (në tekstin e mëtejshme djegia bakteriale), si dhe zbatimin e masave fitosanitare për të eliminuar përhapjen e djegies bakteriale.
2. Në mënyrë që të kryej inspektimin dhe mostrimin, inspektorit të AUV (në tekstin e mëtejshme inspektor) duhet t'i sigurohen pajisjet e nevojshme: gërbërës, thes, letër filtri ose peshqir letre, dorëza për një përdorim, peceta, dezinfektues, spërkatës me ngjyra ose shirit me ngjyra, qese këpucesh njëpërdorimshe.
3. Inspektimet (monitorimi) kryhen në vende të ndryshme në tërë territorin e Kosovës ku bimët nikoqire të djegies bakteriale (në tekstin e mëtejshme bimët nikoqire) kultivohen (në fidanishte, pemishte, kopshte private, kopshte botanike, koleksione bimore, parqe etj.) ose ku ato rriten (gjelbërimi, flora spontane etj.) sipas planit vjetor të punës së AUV.

Bimët nikoqire janë:

 - sqapthi - *Amelanchier* Medik.,
 - *Chaenomeles* Lindl.,
 - *Cotoneaster* Ehrh.,
 - bima e murrizit - *Crataegus* L.,
 - ftua - *Cydonia* Mill.,
 - mushmolla - *Eriobotrya* Lindl.,
 - molla - *Malus* Mill.,
 - mushmolla - *Mespilus* L.,
 - *Photinia davidiana* (Decne.) Cardot,
 - murrizi i kuq - *Pyracantha* M.Roem.,
 - dardha - *Pyrus* L.,
 - vadha (hiri malor) - *Sorbus* L.
4. Inspektimet (monitorimi) për identifikimin e djegies bakteriale kryhen nga 1 maji deri më 31 gusht.
5. Mostrat mund të merren me ose pa simptoma në përputhje me këtë udhëzues. Marrja e mostrave duhet të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Aneksin e këtij udhëzuesi.
6. Mostrat e marra përgatiten në përputhje me kërkesat e përcaktuara dhe dërgohen për testim në Institut Bujqësor të Kosovës ose laboratore tjera të akredituara, të kontraktuara nga AUV (në tekstin e mëtejshme laborator).

 <p>Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë</p> <p>Manuali</p>	<p style="text-align: center;">SOP</p> <p>Procedurat Standarde të Operimit për kryerjen e inspektimeve (monitorimit) dhe mostrimit për identifikimin e djegies bakteriale Erwinia amylovora dhe zbatimin e masave fitosanitare</p>	<p>Dok.-Nr.:07-109-001</p> <p>Versioni: 1.0.</p> <p>Faqe: 7</p> <p>Statusi: 30.01.2019.</p>
--	--	---

II Inspektimi (Monitorimi)

7. Monitorimi vjetor kryhet në vendet që nuk janë inspektuar në vitet e mëparshme (në ngastra tjera) dhe mbulon sa më shumë lloje të ndryshme të bimëve nikoqire.

8. Monitorimi mbulon:

8.1 Në pemishte - 25-50% të sipërfaqes, të cilat duhet të inspektohen përgjatë perimetrit dhe rreshtave por të mbulojnë të gjitha varietetet që janë të pranishme në ngastër:

8.1.1 nëse pemishtja është deri në 3 hektarë, 25-50% të sipërfaqes inspektohet;

8.1.2 nëse pemishtja është më e madhe se 3 ha - të paktën 25% të sipërfaqes inspektohet;

8.2 në pemishtet e vjetra të braktisura jo më pak se 25% të sipërfaqes. Bimët inspektohen përgjatë perimetrit dhe, nëse është e mundur, përgjatë rreshtave;

8.3 në parqe, në buzë të rrugëve, kopshte botanike, koleksione bimore - të gjithë sipërfaqen;

8.4 në florën spontane - të gjithë sipërfaqen e planifikuar të monitoruar.

9. Inspektimi kryhet edhe pas marrjes së informacionit nga personat për praninë e mundshme të djegies bakteriale (simptomat vizuale).

III Inspektimi i materialit shumëzues të bimëve nikoqire në fidanishte

10. Inspektori duhet të qartësojë origjinën e materialit shumëzues (të Kosovës ose import).

11. Të gjithë materialet shumëzuese të bimëve nikoqire, fushat e nënshartesave dhe plantacionet e bimëve amë në fidanishte inspektohen vizualisht.

12. Bimët nikoqire në afërsi 100 m rreth fidanishtes (përfshirë fushat e nënshartesave dhe plantacionet e bimëve amë) gjithashtu inspektohen vizualisht.

13. Gjatë inspektimit të parë në fidanishte, mostrat për identifikimin e formës latente të djegies bakteriale merren në përputhje me skemën e mëposhtme:

13.1 degët për mostër duhet të prehen 10-20 cm dhe gjethet duhet të hiqen;

13.2 sasia e degëve do të jetë 100 copë e së njëjtës specie të bimës nikoqire për çdo 0.3 ha sipërfaqe nëse ka më shumë se 1000 bimë të kësaj gjinie në fidanishte;

13.3 degët në sasi prej 5% të numrit të bimëve nikoqire të gjinise, por jo më pak se 30 degë, nëse ka më pak se 1000 bimë të kësaj gjinie në fidanishte.

14. Sipërfaqja në të cilën kultivohet materiali shumëzues nga i cili janë marrë mostrat për fazën latente dhe numrat e mostrave shënohen në skemë që i bashkangjitet raportit të inspektimit.

15. Vendimi për lejimin e përdorimit të pasaportes bimore (etiketa dhe certifikata e brendshme) për materialin shumëzues merret vetëm pas marrjes së rezultateve të testimit laboratorik, të cilat konfirmojnë se materiali është i lirë nga djegia bakteriale.

 <p>Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë</p> <p>Manuali</p>	<p>SOP</p> <p>Procedurat Standarde të Operimit për kryerjen e inspektimeve (monitorimit) dhe mostrimit për identifikimin e djegies bakteriale <i>Erwinia amylovora</i> dhe zbatimin e masave fitosanitare</p>	<p>Dok.-Nr.:07-109-001</p> <p>Versioni: 1.0.</p> <p>Faqe: 7</p> <p>Statusi: 30.01.2019.</p>
--	--	---

IV Inspektimi i burimeve gjenetike

16. Inspektimi vizual i materialit të burimeve gjenetike kryhet në periudhën e vegjetacionit në përputhje me planin vjetor, duke ekzaminuar secilën bimë.
17. Në rast të simptomave vizuale merret një mostër nga çdo bimë nikoqire.

V Marrja e mostrave në rast të simptomave vizuale të djegies bakteriale

18. Nëse bimët nikoqire në çfarëdo vendi të kultivimit ose florës spontane janë me simptoma vizuale të djegies bakteriale, merret mostra për testim laboratorik. Mostra do të merret në një ekzemplar.
19. Mostra duhet të përbëhet nga degët me gjethe, duke prerë degën afërsisht 10 cm nën zonën e dëmtuar në mënyrë të tillë që të përfshihet një pjesë e gjallë e padëmtuar të degës.
20. Bimët nikoqire me simptoma shenjohen me ngjyrë ose shirit menjëherë pas marrjes së mostrave dhe të dhëna për këtë vendosen në skemë që i bashkangjitet raportit të inspektimit. Skema hartohet qartë në mënyrë që bimët e etiketuara të gjenden lehtësisht.
21. Raporti i inspektimit përmban vendim mbi ndalimin e përkohshëm të lëvizjes së bimëve nikoqire dhe materialit e tyre shumëzues nga vendi i kultivimit ose rritjes deri sa të pranohen rezultatet e testimit laboratorik.
22. Nëse në testet laboratorike nuk është gjetur djegia bakteriale, vendimi mbi kufizimet e përkohshme shqufizohet.

VI Veprimi në rast të identifikimit të djegies bakteriale

23. Nëse testet laboratorike dëshmojnë praninë e djegies bakteriale, masat fitosanitare zbatohen në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 12/2014 për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes djegia bakteriale - *Erwinia amylovora* (këtëj e tutje Udhëzim Administrativ nr. 12/2014).
24. Inspektori kryen inspektimin në vendin e shpërthimit brenda dy ditëve të punës pas pranimi të raportit të testimit dhe regjistron në raportin e inspektimit numrin e bimëve nikoqire të infektuara dhe numrin e bimëve nikoqire me simptomat vizuale të djegies bakteriale, si dhe numrin e bimëve të tjera nikoqire që do të shkatërrohen në bazë të gjinisë.
25. Bimët nikoqire të infektuara dhe bimët nikoqire me shenja vizuale të djegies bakteriale, si dhe bimët e tjera që i nënshtrohen shkatërrimit duhet të shënohen dhe përpilohen me saktësi në skemë që i bashkangjitet raportit të testimit.
26. Nëse djegia bakteriale zbulohet në florën spontane, në një park ose në gjelbërim, privat ose shtetëror duhet të lajmërohet pronari ose personi përgjegjës.

 <p>Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarise</p> <p>Manuali</p>	<p style="text-align: center;">SOP</p> <p>Procedurat Standarde të Operimit për kryerjen e inspektimeve (monitorimit) dhe mostrimit për identifikimin e djegies bakteriale Erwinia amylovora dhe zbatimin e masave fitosanitare</p>	<p>Dok.-Nr.:07-109-001</p> <p>Versioni: 1.0.</p> <p>Faqe: 7</p> <p>Statusi: 30.01.2019.</p>
--	--	---

27. Merret vendimi lidhur me zbatimin e masave fitosanitare dhe krijimin e zonës tampon.
28. Të dy vendimet dërgohen me e-mail shefit të Sektorit Fitosanitar ditën kur është marrë vendimi.
29. Sektori Fitosanitar ose personi nga departamenti i TI-së përgatisin një hartë të zonës së infektuar dhe zonës tampon brenda dy ditë pune, e cila i dërgohet në mënyrë elektronike inspektorit përgjegjës.
30. Harta e zonës tampon dhe zonës së infektuar dhe vendimi lidhur me zbatimin e masave fitosanitare publikohen në faqen e internetit të AUV.
31. Inspektori:
- 31.1 organizon me personin vendin dhe kohën e shkatërrimit të bimës nikoqire dhe e mbikëqyrë shkatërrimin;
 - 31.2 shkruan raport të inspektimit mbi shkatërrimin e bimëve nikoqire dhe aty tregon numrin e bimëve të shkatërruara sipas gjinisë. Raportit të inspektimit i bashkangjitet një skemë që tregon bimët e shkatërruara.

VII Monitorimi në vendin e shpërthimit

32. Nëse gjatë inspektimit monitorues të një vendi të shpërthimit, identifikohen simptomat vizuale në të njëjtën periudhë vegjetacioni; nuk nevojiten mostra shtesë. Masat fitosanitare zbatohen për këto bimë nikoqire me simptoma vizuale dhe bimë nikoqire përreth, në përputhje me Udhëzimin Administrativ të MBPZHR nr. 12/2014.
33. Nëse në vitin vijues, gjatë inspektimit monitorues në vendin e shpërthimit, identifikohen shenja vizuale, merret një mostër për analizë laboratorike.

 <p>Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë</p> <p>Manuali</p>	<p style="text-align: center;">SOP</p> <p>Procedurat Standarde të Operimit për kryerjen e inspektimeve (monitorimit) dhe mostrimit për identifikimin e djegies bakteriale Erwinia amylovora dhe zbatimin e masave fitosanitare</p>	<p>Dok.-Nr.:07-109-001</p> <p>Versioni: 1.0.</p> <p>Faqe: 7</p> <p>Statusi: 30.01.2019.</p>
--	--	---

Aneksi

Kërkesat për inspektimin, marrjen e mostrave dhe përgatitjen e mostrës për testimin laboratorik

1. Para inspektimit, dezinfektohen mbathjet me dezinfektues (produkt me përmbajtje klori), por në fidanishte është obligative të përdoren qese këpucesh njëpërdorimshe.
2. Dezinfektuesi përdoret duke e spërkatur atë në sipërfaqen e mbathjeve dhe duke e larë pjesën e poshtme të mbathjeve me pecetë ose peshqir letre.
3. Gjatë inspektimit në fidanishte, përdoret një thes i cili duhet të jetë për një përdorim, në të cilin hudhen të gjitha peceta, peshqira letre, dorëza etj. të përdorura.
4. Mostrat merren me dorëza për një përdorim, të cilat zëvendësohen pas çdo mostre të marrë.
5. Nëse bima ka simptoma vizuale dhe degët ose filiza mund të thyhen me dorë, rekomandohet që mos të përdoren gërshërët. Në këtë rast, nuk është e nevojshme të dezinfektohen dorëzat dhe ato duhet të vendosen në thes së bashku me mostrën.
6. Nëse te bimët në fidanishte nuk ka simptoma vizuale inspektori përdor ose gërshërët e tij ose të fidanishtes.
7. Pajisjet për marrjen e mostrave dezinfektohen pas mostrimit:
 - 7.1 gërshërët dhe pajisjet e tjera (thikë) dezinfektohen pas çdo mostre;
 - 7.2. në fund të ditës së punës, gërshërët lahen me sapun;
 - 7.3. në fund të mostrimit në vendin e inspektimit, këpucët duhet të dezinfektohen me dezinfektues siç përshkruhet në paragrafin 1 dhe 2 të Aneksit. Dezinfektimi i këpucëve kryhet edhe pas kryerjes së inspektimit dhe marrjes së mostrave. Nëse simptoma janë vërejtur në njërin nga fushat dhe inspektimi vazhdon në një fushë tjetër, mbathjet duhet të dezinfektohen ndërmjet këtyre fushave.
8. Përgatitja e mostrës për dërgim në laborator:
 - 8.1. mbështjellni mostrën në një letër filtri të thatë ose peshqir letre dhe vendoseni në një qese polietileni.
 - 8.2. pasi të vendosni mostrën në qese të mostrimit, hiqni dorëzat dhe vendosini ato së bashku me mostren;
 - 8.3. mostra përgatitet për dërgim në laborator në përputhje me udhëzimin e përgjithshëm të mostrimit të shërbimit fitosanitar.
9. Nëse dorëzat janë trajtuar me dezinfektues, ato nuk vendosen bashkë me mostrën.
10. Dorëzat e dezinfektuara (dhe qese këpucesh njëpërdorimshe) vendosen në qese për mbeturina. Për çdo vend inspektimi përdoret një qese e re për mbeturina.
11. Qesja e mbeturinave me materiale të dezinfektuara të përdorura nuk mund të hidhet së bashku me mbeturinat shtëpiake. *versioni 2* duhet të digjet.